

Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 26.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.05.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik NBT ING, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Renovimi dhe mirembajtja e objekteve komunale”**, me Nr. të Prok: **616 21 024 521**nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të NBT ING të dt. 22.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“ Renovimi dhe mirembajtja e objekteve komunale**, me Nr. **616 21 024 521**, kundër *[Njoftimit për dhënie të Kontratës]* të AK –së, të datës 17.05.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. *[Vërtetohet]* vendimi i AK për *[dhënien e kontratës/njoftimin për kontratë]* të publikuar me datë: 17.05.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *[te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit /aktivitetin e Prokurimit të ktheje në Rivlersim]*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-E para ju perkujtojme se nuk qendron pretendimi juaj se sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet nuk eshte dashte t'iu kerkojme sqarime shtese,sepse ne rregulla eshte e dhene edhe pika 3.2 qe percakton(citojme):

"Kur tenderet duken te jene jonormalisht te ulet per arsye te tjera nga ato te parashikuara ne paragrafin 3.1 te ketyre rregullave,autoritetet kontraktuese mund te vleresojne besueshmerine e tendereve te tille dhe rrjedhimisht te kerkojne shpjegime ne perputhje me paragrafet e meposhtem dhe nenin 61 te LPP-se.


-Pretendimet tuaja jane te pa bazuara edhe per faktin se ju nuk keni dhene sqarime dhe deshmi si qe jane paraqitur ne kerkesen tone per sqarime dhe si qe eshte percaktuar ne nenin 4.4.te Rregullave;

-Pretendimi se tenderuesi i rekomanduar per kontrate ka poashtu çmime jonormalisht te ulta ne disa pozicione eshte pjeserisht i qendrueshem,por komisioni profesional ka konstauar se ato çmime jane dhene ne pozicione qe kane shume pak rendesi per realizimin e projektit,ndersa ne tendein tuaj ka çmime te tilla ne shume pozicione.Lidhur me kete ju sqarojme se ju keni çmime abnormalisht te uleta ne krahasim me kete tenderues ne me shume se pesedhjete pozicione dhe ju ne sarimet tuaja nuk keni ofruar asnje argument per favorizimet dhe perpresite tuaja eventuale per te realizuar projektin me te njejtat.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit